

VENDIM
Nr.67, datë 27.7.2011

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DOSKU-ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1, germa “a”, neni 15 pika 3, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1 germa “a”, 5, pika 1 germa “a”, 8 pika 4 dhe neni 13 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.7.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Dosku–Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Dosku Energy” sh.p.k. plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “f” dhe “g”) janë plotësuar plotësisht me përjashtim të kërkesës së gjerës “e” për shkak të mungesës së certifikatës së regjistrimit të pronësisë së subjektit “Dosku-Energy” sh.p.k.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, “b” dhe “d”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Gizavesh”, me kusht që subjekti “Dosku Energji” sh.p.k. të paraqesë certifikatën e regjistrimit të pronësisë brenda 2 (dy) vjetësh nga data e dhënies së licencës.

2. Afati i kohëzgjatjes së licencës do të jetë 30 vjet.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Sokol Ramadani